



UNMIK/REG/2005/43
7 shtator 2005

RREGULLORE NR. 2005/43

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN E TË
RRITURVE I MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 e 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 29 korrik 2005 lidhur me Ligjin për arsimin dhe aftësimin e të rriturve të miratuar nga Kuvendi më 22 korrik 2005,

Me anë të kësaj shpall Ligjin për arsimin dhe aftësimin e të rriturve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-24), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që fjala “Kosova” të zëvendësohet në tërë tekstin e Ligjit në gjuhën angleze me “Kosovo” e cila pasqyrohet në tekstin përfundimtar zyrtar të ligjit.

Nënshkuar sot më 7 shtator 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-24

PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN E TË RRRITURVE

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9, të 15 majit 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe veçanërisht Kreu 5.1(d), 9.1.1, 9.1.26(a),

Me qëllim të zhvillimit të një aktiviteti të arsimit dhe aftësimi të të rriturve,

Miraton:

LIGJIN PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN E TË RRRITURVE

I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimet e arsimit për të rritur
Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij Ligji është të promovoj arsimit dhe aftësimin gjatë gjithë jetës për të gjithë individët e interesuar.

1.2. Ligji paraqet kornizë për sistemin e arsimit dhe aftësimi për të rritur, përfshirë mësimin kompenzues dhe formata tjera të arsimit dhe aftësimi për të rritur, që nuk rregullohen me Ligjet për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, për Arsimin e Lartë dhe për Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Korniza nuk zbatohet për arsimin dhe aftësimin për të rritur, të ofruar nën mandatet statutorë të institucioneve qeveritare sipas Rregullores 2001/19 (e ndryshuar) ose i cili përndryshe realizohet jashtë institucioneve të arsimit dhe aftësimi që rregullohen me këtë ligj.

1.3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, brenda përgjegjësi së saj ligjore, do të krijoj kushtet e domosdoshme për të rriturit për përvetësimin e shkathtësive, njohurive dhe qëndrimeve në pajtim me nevojat e tyre dhe të shoqërisë.

Përkufizimet
Neni 2

“Agjencioni i Akreditimit të Kosovës” (AAK)

“**I rritur**” nënkupton çdo person, që i ka mbushur 18 vjet, sipas Rregullores nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë. Megjithatë, dispozitat e këtij ligji, gjithashtu, zgjerohen në përfshirjen e atyre, që i kanë mbushur 15 vjet e më shumë, të cilët janë në

moshën kur përfundon edukimi i obligueshëm dhe kanë të drejtë të hyjnë në tregun e punës dhe të marrin pjesë në programet e mësimi të dizajnuara për të rritur. Personat nën moshën 18 vjeçare mund të kërkojnë leje nga prindërit për lidhjen e kontratave për mësim.

”Arsimi dhe aftësimi për të rritur” nënkupton tërë arsimin dhe aftësimin publik dhe privat të ofruar për të rriturit dhe / ose për të rinjtë mbi moshën 15 vjeçare, të cilët kanë të drejtë të ndjekin programet e mësimi, të hartuara për të rriturit.

“Institucioni për arsim dhe aftësim” në kontekst të këtij ligji nënkupton shkollën ose çdo lloj tjetër të institucionit publik ose privat, i licencuar të ofrojë programe të arsimit dhe aftësimi formal për të rritur. Ky përkufizim nuk i përfshinë as punëdhënësit e as ndërmarrjet, që ofrojnë aftësim në punë për punëtorët e tyre, ose organizatat, që ofrojnë kurse jo-formale, seminare dhe / ose mundësi për mësim, përveç atyre që janë saktësisht të mbuluara nga ky ligj.

“Vijues” është çdo person i regjistruar në çfarëdo programi për arsimin dhe aftësimin e të rriturve.

“Viti shkollor” do të thotë periudha kohore e caktuar nga institucioni i MASHT-it.

“Këshilli për shqyrtimin e aftësimi të mësimdhënësve” do të thotë struktura me këtë emër ose me një emër tjetër i themeluar nga MASHT-i me kompetencën për të miratuar kualifikimin, rikualifikimin dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

“ISCED” është Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit, e publikuar nga UNESCO, në të cilin bazohen nivelet e arsimit në Kosovë, siç definohet në Aneksin të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm.

“Andragog” do të thotë mësimdhënësi që është aftësuar për punën me të rritur.

“Certifikimi” është njohje zyrtare e të arriturave, që njeh përfundimin e arsimit ose aftësimi ose realizimin e pranueshëm në një test ose provim. Në kontekstin e arsimit dhe aftësimi të të rriturve, është shprehje formale e të arriturave të nxënësit (në lidhshmëri me shkathtësitë, njohuritë dhe qëndrimet).

“Çertifikatë” nënkupton çdo dokument, që jepet pas përfundimit të suksesshëm të një kursi, programi të arsimit ose aftësimi ose pas dhënies së provimeve në institucionin e arsimit dhe aftësimi, i regjistruar dhe i licencuar në mënyrë të rregullt.

“E-learning” të mësuarit me ndihmën e teknologjive informative e komunikative (TIK).

“Të mësuarit informal” të mësuarit që fitohet në jetën e përditshme, në vendin e punës, në gjirin e familjes ose në kohën e lirë .

“Të mësuarit formal” bazohet në programet e mësimi, që ofrohen në institucionet e licencuara të arsimit dhe aftësimi, të cilat përdorin programet e aprovuara dhe të nxjerra nga MASHT-i. Mësimi i tillë është i strukturuar dhe çon në certifikim.

“Të mësuarit joformal” bazohet tek programet e mësimi, që dallojnë nga ato të përfshira në përkufizimin e mësimi formal në këtë ligj. Ky mësim mund të realizohet brenda institucioneve të njëjta të arsimit dhe aftësimi, që ofrojnë programe të mësimi formal ose plotësisht në mënyrë të pavarur. Megjithatë, kjo formë e mësimi është sistematike sa i përket objektivave, kohëzgjatjes dhe mjeteve të mësimi.

”**Të mësuarit kompensues**” përfitimi i mëvonshëm i kualifikimeve bazë, që në fakt duhej të ishin marrë gjatë periudhës së arsimit të detyrueshëm.

“**Të mësuarit gjatë gjithë jetës**” përfshin të gjitha aktivitetet e mësimit, që ndërmerren gjatë jetës për zhvillimin e kompetencave dhe kualifikimeve.

“**Vlerësimi i të mësuarit**” është çmuarja e të arriturave të nxënësve lidhur me shkathhtësitë, njohuritë dhe qëndrimet. Përkufizimi mund të përfshijë metoda të shumta të metodave të çmuarjes, duke përfshirë provimet teorike dhe praktike.

Neni 3

MASHT-i, në bashkëpunim me ministritë tjera, Zyrat Rajonale të Arsimit (ZRA) dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), koordinon planifikimin, zhvillimin dhe implementimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur.

Përshtatja e sistemit arsimor për të rritur.

Neni 4

Brenda fushës së veprimtarisë së këtij ligji, MASHT-i duhet ta përshtatë tërë procesin arsimor për të rritur me shkathhtësitë, prirjet dhe moshën e vijuesve.

Neni 5

Në institucionet publike të arsimit dhe aftësimin të të rriturve ndalohet veprimtaria propaganduese politike dhe fetare.

Neni 6

Arsimi dhe aftësimi i të rriturve është pjesë integrale e sistemit të arsimit në Kosovë.

Organizimi i arsimit dhe aftësimin të të rriturve

Neni 7

7.1. Arsimi dhe aftësimi për të rritur, siç është përkufizuar në nenin 1 të këtij ligji, organizohet në institucionet e arsimit dhe aftësimin, të regjistruara dhe të licencuara për këtë qëllim, nën rregullimet e përcaktuara në një Udhëzim Administrativ.

7.2. Institucionet e arsimit dhe aftësimin, të licencuara për të organizuar mësimin e mbuluar me këtë ligj, duhet të jenë të regjistruara si persona juridikë.

Rregullimi dhe kontrolli

Neni 8

MASHT-i ka përgjegjësi të mbështesë dhe të kontrollojë zbatimin e këtij ligji.

Programi arsimor

Neni 9

9.1. Programet për arsimin dhe aftësimin publik të të rriturve hartohen dhe miratohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, në bashkëpunim me ministritë tjera.

9.2. Bartësit e arsimit dhe të aftësimit privat i hartojnë programet e tyre, të cilat i miraton MASHT-i.

9.3. Programet për arsimin dhe aftësimin e të rriturve duhet të jenë në pajtim me standardet bashkëkohore Evropiane.

Provimet

Neni 10

Provimet, që organizohen për të rriturit, që vijojnë programet e arsimit kompenzues, ose që kërkojnë certifikim formal, duhet të jenë në pajtim me kërkesat standarde ekzistuese për nxënësit e rregullt.

Dokumentet

Neni 11

Çertifikatat dhe diplomat, që dëshmojnë të arriturat e nxënësve në programet e arsimit për të rritur, të organizuara sipas këtij Ligji, duhet të jenë të standardizuara dhe të miratuara nga MASHT-i.

Pagesa

Neni 12

Shkollimi në nivelin e arsimit të obliguar sipas Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm është falas, ndërsa për arsimin dhe aftësimin jo obligues bëhet participimi në bazë të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga MASHT-i.

Jodiskriminimi

Neni 13

Vijuesit e rritur kanë të drejtë të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa diskriminim në bazë etnike, bindjet politike ose fetare, origjinën kombëtare dhe shoqërore, përkatësinë gjinore dhe aftësitë e kufizuara.

II - DISPOZITAT E VEÇANTA

Plani vjetor i punës

Neni 14

14.1. Puna arsimore në institucionet për arsimin dhe aftësimin e të rriturve realizohet përmes programeve arsimore publike dhe private sipas planit vjetor të punës.

14.2. Plani vjetor i punës i institucioneve të arsimit dhe aftësimit, duhet të hartohet në pajtim me kërkesat e caktuara me Udhëzim Administrativ, që do të nxjerrët nga MASHT-i.

Programet dhe evidenca

Neni 15

15.1. Institucionet dhe organizatat e tjera edukativo-arsimore janë të obliguara që programet arsimore si dhe organizimin e punës, t'i paraqesë për miratim në MASHT.

15.2. Institucionet dhe organizatat e arsimit dhe aftësimit për të rritur mbajnë evidencën e rregullt të punës së tyre.

Regjistrimi-konkursi publik

Neni 16

16.1. Në arsimin dhe aftësimin sipas programeve të caktuara vjetore të rriturit regjistrohen në bazë të konkursit publik.

16.2. Konkursi i publikuar duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a) Kushtet e kërkuara për regjistrim në pajtim me këtë ligj që përfshijnë programet përkatëse arsimore dhe standardet e tjera të caktuara nga institucionet e arsimit për të rritur;
- b) Numrin e vendeve të lira të parapara për regjistrim;
- c) Mënyrën dhe kushtet e realizimit të arsimit dhe aftësimit si dhe kushtet e përfundimit me sukses të tij;
- d) Lartësia e pagesës për vijuesit.

16.3. Konkursi nga paragrafi 16.1, 16.2 duhet të publikohet më së voni në afat prej një muaj para fillimit të mësimit.

16.4. Në interesat e mbrojtjes së vijuesit, në veçanti nën moshën 18 vjeçare, MASHT-i do të nxjerr një Udhëzim Administrativ, që do të rregullojë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, si dhe aspektet e kontratave të mësimit për programet e mësimit për të rritur, të mbuluara me këtë ligj.

Regjistrimi

Neni 17

Kriteret e përzgjedhjes duhet të marrin parasysh nevojat e individit për mësim dhe kapacitetin e tyre për të ndërmarr mësimin e ofruar, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me konkurs.

Regjistrimi sipas kontratës

Neni 18

18.1. Të rriturit mund të regjistrohen në programet arsimore të cilat nuk financohen, nuk subvencionohen as nuk bashkë financohen nga mjetet publike edhe në bazë të kontratës të cilën e lidhin me Institucionet dhe organizatat arsimore për të rriturit.

18.2. Regjistrimi sipas kontratës bëhet përmes udhëzimit administrativ të nxjerrë nga MASHT-i.

Veçoritë e tjera të organizimit të arsimit për të rritur
Neni 19

19.1. Kohëzgjatja e programeve dhe planifikimi i realizimit të punës arsimore për të rriturit, mund të rregullohet ndryshe nga kalendari i rregullt shkollor i institucioneve arsimore.

19.2. Institucionet dhe organizatat arsimore të cilat organizojnë kurse certifikuese duhet të paku dy herë në vit të publikojnë afatet për provime nga programet arsimore që i realizojnë.

19.3. Specifikave, nevojave dhe mundësive të pjesëmarrësve në arsimin e të rriturve i përshtatet edhe kohëzgjatja e arsimit, renditja e mësimit të lëndëve ose të pjesëve të tyre, mënyrat dhe format e vlerësimit.

Vijuesit e arsimit dhe aftësimin të të rriturve
Neni 20

Vijuesit në arsimin dhe aftësimin për të rritur përvetësojnë dituri, shkathtësi e shprehje sipas programeve arsimore të veçanta për të rritur, si dhe të pjesëve të programeve arsimore për të rinj.

III - PROGRAMET ARSIMORE

Neni 21

21.1. Programet për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, pavarësisht se a ofrohen me pagesë ose pa pagesë, hartohen që të zhvillojnë shkathtësi, njohuri dhe shprehje në pajtim me objektiven për ngritjen e nivelit të përgjithshëm të arsimit, kulturës dhe kompetencave profesionale të të rriturve. Programet e tilla duhet të përfshijnë shkathtësi bazë, edukatën qytetare dhe demokracinë, mësimin e synuar për minoritetet dhe për të rriturit me nevojat veçanta, mësimi i gjuhëve të huaja, mësimi i gjuhës shqipe nga të huajt dhe arsimin tjetër për të rritur.

21.2. Arsimi dhe aftësimi dëshmohet me dokument zyrtar sipas programeve arsimore për të rritur dhe programet e tjera arsimore, të përcaktuara sipas ligjit, të cilat nuk e rregullojnë fushën e arsimit për të cilat MASHT-i ka përcaktuar standardin arsimor të barasvlershëm, ose ndaj pjesëve të programeve arsimore për të rinjtë sipas të cilave arrihet arsimi publik.

21.3. Barasvlera dhe nostrifikimi i këtyre dokumenteve bëhet me udhëzim administrativ.

Verifikimi i arsimit dhe aftësimin.
Neni 22

22.1. Kualifikimet për të rritur fitohen duke iu nënshtruar provimeve pasi të kenë ndjekur programin përkatës të arsimit.

22.2. Arsimi dhe aftësimi mund të arrihet edhe me verifikimin dhe dëshmimin e diturive, me provime ose në bazë të dokumenteve zyrtare.

Neni 23

23.1. Vijuesit përmes provimeve dëshmojnë diturinë, shkathtësi dhe kompetencat e tyre, në institucionin ku realizohet programi arsimor pa marrë parasysh mënyrën e arritjes së saj.

23.2. Në rastet kur sipas nenit 9 të këtij ligji, dëshmohet dituria nga programet arsimore sipas të cilave arrihet arsimi dhe aftësimi, mbi barasvlerën, nivelin e njohurive, të cilat verifikohen dhe dëshmohen përmes provimeve, në institucionet përkatëse për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, vijuesi merr dokument zyrtar.

Neni 24

24.1. Programi i arsimit dhe aftësimit çertifikues për të rriturit ka pjesën e përgjithshme dhe të veçantë.

24.2. Vëllimi dhe përmbajtja e programeve arsimore për të rriturit që përfshin arsimin dhe aftësimin, përcaktohen në harmoni me ligjet që i rregullojnë këto segmente të arsimit dhe me udhëzimet administrative të MASHT-it.

Publikimi i programit arsimor.

Neni 25

Programi arsimor për aftësimin dhe arsimin e të rriturve duhet që para shpalljes së konkursit për regjistrim të publikohet në mjetet e informimit publik.

IV - KUSHTET

Të ushtruarit e veprimtarisë

Neni 26

26.1. Për qëllim të këtij ligji, arsimi dhe aftësimi do të realizohet nga individët të cilët e kanë kualifikimin e përshtatshëm për programin që ofrohet. Kjo mund të përfshijë mësuesit, trajnerët, instruktorët ose ekspertët e tjerë.

26.2. MASHT-i nxjerr udhëzime administrative për mënyrën dhe afatet e plotësimit të kushteve të parapara me këtë ligj.

26.3. Çështjet statusore të institucioneve dhe organizatave për arsimin dhe aftësimin e të rriturve dhe kushtet për arsimtarë dhe bashkëpunëtorë rregullohen në përputhje me këtë ligj.

Kushtet

Neni 27

27.1. MASHT-i, pasi që të merr mendimin e Agjencionit Kosovar për Akreditim, dhe të institucioneve tjera do të përcaktojë kushtet dhe kriteret për financimin e institucioneve publike për arsimin dhe aftësimin e të rriturve.

27.2. Institucionet e arsimit dhe aftësimit për të rritur, që financohen nga mjetet publike, do t'i përmbushin kushtet dhe kriteret minimale, të cilat do të caktohen në një udhëzim administrativ, të nxjerr nga MASHT-i. Udhëzimi Administrativ relevant do të mbulojë çështjet siç janë:

- a) kualifikimet për rikat se arsimore dhe andragogjike;
- b) burimet materiale/fizike (hapësira, pajisjet dhe materiale ndihmëse të mësimdhënies);
- c) rregullimet për siguri dhe shëndetësi.

Neni 28

28.1. Kushtet minimale dhe standardet e lokaleve dhe të mjeteve për drejtimin arsimor, i përcakton Ministria e Arsimit (në tekstin në vazhdim: ministria).

28.2. Me rastin e përgatitjes së udhëzimit Ministria është e obliguar të marrë mendimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK), Këshillit të Ekspertëve për hartimin e plan programeve dhe teksteve shkollore dhe Agjencioneve tjera për rikat se.

Regjistrimi dhe licencimi

Neni 29

29.1. Institucionet dhe organizatat për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, të cilat realizojnë programe publike të vlefshme ose programe që financohen nga mjetet publike, mund të realizojnë veprimtari arsimore pasi të jenë regjistruar në regjistrin e institucioneve dhe organizatave arsimore për arsimin dhe aftësimin e të rriturve (më tutje: Regjistri) të cilin e udhëheq MASHT-i.

29.2. Formën dhe përmbajtjen e regjistrit e vërteton Ministria e Arsimit.

Përgjegjësitë

Neni 30

30.1. MASHT-i përgatit katalogët dhe standardet vlerësuese të njohurive, zotërimi i së cilave është kusht për të marrë një dokument të nivelit të caktuar.

30.2. Për qëllime të kualifikimit, të arriturat në arsim dhe aftësim, që dëshmohen nëpërmjet certifikimit dhe dokumenteve tjera zyrtare nga programet e veçanta për arsimin e të rriturve ose programet e tjera, që janë përshtatur për të rinjtë nga pjesë të tjera të arsimit, do të përshtaten me standardet, që kërkohen në programet e arsimit formal.

V - INSTITUCIONI I VLERËSIMIT

Neni 31

31.1. Institucioni i vlerësimit (Shkolla dhe institucioni ku bëhet arsimimi dhe aftësimi) i nivelit përkatës bën vlerësimin e njohurive të fituara, dhe për këtë qëllim:

- a) Formon komisionet vlerësuese për fusha teorike dhe praktike,
- b) Shpall afatet dhe cakton kriteret për vlerësimin e njohurive dhe mban evidencë për rezultatet e arritura,
- c) Lëshon dokumente për dhënien e provimit ose mbarimin e një niveli të caktuar me sukses të pritshëm,
- d) Dokumentet e fituara gjatë këtij aftësimi do të jenë të barasvlershme me dokumentet e arsimit të rregullt shkollor.

31.2. Pas përfundimit me sukses të kursit këto dokumente (certifikata, diploma) do të jenë të barasvlershme me standardet e sistemeve bashkëkohore ndërkombëtare.

Evidenca Neni 32

32.1. MASHT-i nxjerr udhëzime administrative lidhur me regjistrimin, mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale në pajtim me këtë ligj dhe ligjet tjera për këtë fushë.

32.2. Në rast të përpunimit statistikor të të dhënave dhe analizës, të dhënat personale mund të shfrytëzohen ose paraqiten vetëm në atë formë, ku identiteti i nxënësve mbetet i panjohur.

Themelimi i Institucioneve për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve Neni 33

33.1. Institucionet publike për arsimin dhe aftësimin e të rriturve i themelon MASHT-i në bashkëpunim me ministrin tjetër.

33.2. Institucionet për arsimin dhe aftësimin e të rriturve mund të themelohen si institucione publike ose të organizohen në shkollë, në organizata për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, të cilat janë të regjistruara dhe të licencuara në bazë të ligjit.

33.3. Institucioni publik për arsimin dhe aftësimin e të rriturve mund të themelohet sipas kushteve të parapara me këtë ligj.

33.4. Institucionet private për arsimin dhe aftësimin e të rriturve themelohen nga persona juridikë privatë dhe licencohen nga MASHT-i.

VI - QEVERISJA

Drejtori, udhëheqësi Neni 34

34.1. Drejtori, është drejtues dhe udhëheqës i punës së institucionit për arsimin dhe aftësimin e të rriturve.

34.2. Udhëheqësin e Institucionit publik për arsimin dhe aftësimin e të rriturve e zgjedh themeluesi.

34.3. Udhëheqësin e institucionit privat e zgjedh themeluesi.

34.4. Drejtori, ndihmësdrejtori, udhëheqësi, duhet të ketë të mbaruar përgatitjen universitare dhe së paku tre vjet përvojë profesionale në fushat e arsimit përkatës.

Struktura e qeverisjes

Neni 35

35.1. Organizimi i brendshëm i institucioneve publike për arsimin dhe aftësimin të të rriturve, rregullohet nga dispozitat ekzistuese të qeverisjes dhe menaxhimit, e përkufizuar me legjislacionin e duhur, që zbatohet në institucion.

35.2. Institucionet publike për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve, të themeluara posaçërisht për realizimin e programeve të rregulluara me këtë ligj, formojnë një Këshill drejtues, në kuadër të të cilit përfshihen andragogët, ekspertët, udhëheqësit e aftësimin praktik. Një Këshill i tillë drejtues do të mbajë takime të rregullta për:

- a) Zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve për arsimin dhe aftësimin e të rriturve;
- b) Dhënien e mendimeve për hartimin dhe zbatimin e planeve vjetore të punës;
- c) Propozimin e masave për përmirësimin e sasisë dhe cilësisë së mësimin;
- d) Përcaktojnë kriteret për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive të vijuesve.

VII - FINANCIMI

Neni 36

36.1. MASHT-i dhe ministrit tjerë në kuadër të buxhetit të tij ndanë linjë të veçantë buxhetore për financimin e programit vjetor për arsimin për të rritur.

36.2. Me aktin e themelimit të linjës së re buxhetore, caktohen edhe burimet, mënyra dhe kushtet mbledhjes së mjeteve për realizimin e programit vjetor të arsimit dhe aftësimin për të rritur.

36.3. Programin vjetor të arsimit të të rriturve mund ta ndihmojnë edhe donatorët e brendshëm dhe të jashtëm.

VIII - DISPOZITAT NDËSHKUESE

Gjykitja

Neni 37

37.1. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë për organizimin e arsimit dhe aftësimin të të rriturve nga personat juridikë dhe fizikë pa u regjistruar dhe pa u licencuar.

37.2. Në rast të ushtrimit të veprimtarisë për organizimin e arsimit dhe aftësimin të të rriturve pa u regjistruar dhe pa u licencuar, personi juridik dënohet me gjobë në shumë prej 10.000 Euro.

37.3. Personi fizik përgjegjës i cili ushtron veprimtarin e organizimit të arsimit dhe aftësimin të të rriturve pa u regjistruar dhe pa u licencuar dënohet me gjobë në shumë prej 2.500 Euro .

37.4. Mjetet nga pagesat e gjobave derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Dispozita kalimtare

Neni 38

38.1. Institucionet arsimore publike të cilat janë të licencuara dhe që organizojnë procesin mësimor për të rritur gjerë në nxjerrjen e këtij ligji nuk kanë nevojë të licencohen, por janë të obliguar që aktet normative të harmonizojnë me këtë ligj në afat prej 6 muajve.

38.2. MASHT-i në bashkëpunim me ministritë tjera nxjerr udhëzime administrative për të plotësuar dhe implementuar këtë ligj.

Neni 39

Afati për nxjerrjen e udhëzimeve administrative të parapara me këtë ligj do të jetë gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 40

Të gjitha institucionet dhe organizatat e arsimit dhe aftësimit për të rritur brenda afatit prej 6 muajsh duhet të regjistrohen dhe licencohen .

Neni 41

41. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë së vlejuri të gjitha dispozitat ligjore që kanë rregulluar këtë lëmi.

41. Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga P rfaq suesi Special i Sekretarit t P rgjithsh m.

Ligji Nr. 02/L-24
22 korrik 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci